

## **Trajnim në temë “Decentralizimi dhe menaxhimi me bashkësi multietnike”**

Më 29 dhe 30 maj 2008 në Ohër u mbajt trajnim në temë “Decentralizimi dhe menaxhimi me bashkësi multietnike”. Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të fitojnë dituri për procesin e decentralizimit dhe mënyrat e menaxhimit me bashkësi multietnike. Gjithsej 24 pjesëmarrës nga përkatësi të ndryshme etnike (maqedonas, shqiptar, turq, rom, egjiptas dhe vllleh) morën pjesë në trajnim. Nga aspekti i orientimit profesional, trajnimin e ndoqën 15 përfaqësues të organizatave joqeveritare nga Resnja, Manastiri, Ohri dhe Struga (nga organizata të pakicave, grave dhe të rinjve) dhe 9 përfaqësues nga institucione lokale nga Resnja dhe Struga (këshilltarë nga komuna e Resnjës dhe Strugës, kryetari i Këshillit të Komunës së Strugës, mësimdhënës nga shkolla fillore dhe të mesme me përbërje multietnike).

Pas sqarimit të termit decentralizim dhe zbatimit të tij në kushte maqedonase vijoi ushtrim praktik për sfidat e decentralizimit në vendin tonë. U identifikuan problemet që shfaqen gjatë transferimit të kompetencave në nivel lokal duke i përfshirë këtu edhe mjetet që parashihen për at qëllim. Bashkarish u përpunuan edhe konceptet kombit, popullit, kulturë, shtet, multietnik, multikulturor dhe multikulturalizëm. Për secilën nga modelet e ndryshme të zgjedhjes së konflikteve në shoqëri me kulturë të ndryshme, trajnuesit Zhidas Daskalovski dhe Marija Risteska nga Qendra për Hulumtime dhe Krijimin e Politikave kishin përgatitur prezantime me pjesë teorike dhe adaptime në sistemin politik të Maqedonisë. Pjesëmarrësve iu dha temë për diskutim që kishte të bëjë me problemet në vijim: arsimit në gjuhën e bashkësive etnike jo shumicë, ndarja e medimeve dhe sektorit të kulturës në bazë përkatësisë etnike/gjuhësore). U propozuan dhe me sukses u realizuan ushtrime në tema të ndryshme, edhe atë: politikë arsimore, ligji për festa fetare dhe etnike, segregimi etno-kulturor i medimeve, shënimi i territorit me simbole fetare dhe ngjashëm. Zgjidhje të mundshme të cilat u pranuan nga grupi ishin ngjarje të përbashkëta kulturore, debate, tribuna dhe diskutime publike për problemet që shfaqen dhe zgjidhja e të cilëve mundet të arrihet me një bashkëjetesë të qetë.

Trajnimi u organizua nga ana e Fondacionit Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrat lokale të projektit në Resnje dhe Strugë (Qendra për përkrahjen e bashkësive Resnje dhe Shoqata për zhvillimin e aktivizmit AKVA nga Struga, ish Qendrat për Përkrahjen e OJQ-ve.)